

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME- GJIROKASTËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga 01.01.12 deri 30.06.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 192 datë 31.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 888/7 datë 31.12.2014, dërguar Z. Dashamir Qeli, Drejtor i SHA Ujësjellës Kanalizime, Gjirokastrë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga SHA Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, në ekstraktin historik të regjistrit tregtar në QKR nuk janë bërë azhurnimet nga viti 2008 për ndryshimet e mëvonshme deri në momentin aktual, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, neni 6 “statuti” dhe neni 106 “regjistrimi”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, që të bëhen të gjitha azhurnimet përkatëse të vendimeve për ndryshime të shoqërisë, pranë QKR Gjirokastrë.

Deri me 31.03.2015

2. Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë UK Gjirokastrë nuk është mbledhur për të bërë emërimin e Këshillit Mbikëqyrës në përfundim të mandatit tre vjeçar, siç përcaktohet në nenin 16 të Statutit të shoqërisë, i cili përkon me muajin Janar 2014, në kundërshtim me nenin 15 të VKM nr. 678, datë 03.10.2007 “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Kryetari i Asamblesë të Aksionerëve të shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, të bëjë emërimin e Këshillit Mbikëqyrës, në zbatim të VKM nr. 678, datë 03.10.2007 “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.

28.02.2015

3. Këshilli Mbikëqyrës i UK Gjirokastrë nuk ka bërë zgjedhjen e një zëvendëskryetari, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 të nenit 19 të VKM nr. 678, datë 03.10.2007, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore” si dhe pikën 9 të kreut III të Udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e VKM Nr. 660, datë 12.09.2007, për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve të njësisve të qeverisjes vendore”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, që të bëjë emërimin e Zëvendëskryetarit në zbatim të Vendimit nr. 678, datë 03.10.2007, të vendimit nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave, të Udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e VKM Nr. 660, datë 12.09.2007.

28.02.2015

4. Nga Drejtoria i UK Gjirokastrë është hartuar rregullorja e brendshme, por në skemën e strukturës organizative mungon njësi juridike dhe shoqëria ushtron aktivitetin e saj pa jurist, në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria i shoqërisë SHA Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë, që në strukturën organizative të shtojë sektorin e njësisë juridike dhe të bëjë emërimin e një Juristi në zbatim të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA”.

31.01.2015

5. Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjet e anëtarëve të tij punon pa mbajtur regjistër të pjesëmarrjes, i cili duhet të nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët pjesëmarrës, veprim ky në kundërshtim me pikën 8, neni 20, të VKM nr. 678, datë 03.10.2007, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës që në zhvillimin e mbledhjeve të mbajë një regjistër për të pasqyruar mbledhjet e mbajtura, pjesëmarrjen e anëtarëve dhe nënshkrimin nga ana e tyre, në zbatim të VKM nr. 678, datë 03.10.2007, pika 8, neni 20, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 9.5.1998.

28.02.2015

6. Drejtoria i Shoqërisë së SHA UK Gjirokastrë ka miratuar Kontratën kolektive të punës për punonjësit pa përfshirë të gjithë elementët thelbësorë të parashikuara sipas pikës (3), neni 21 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime si dhe Këshilli Mbikëqyrës që në hartimin e kontratës kolektive të përfshihen të gjithë elementët thelbësorë, sipas pikës 3, të nenit 21 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar.

31.01.2015

7. Në programet financiare afatmesme nuk është përfshirë plani strategjik i zhvillimit, objektivat, misioni, fushat prioritare si dhe projektet. Në programet vjetore ekonomike-financiare, planifikimi i treguesve të prodhimit, faturimit dhe arkëtimit është bërë i pastudiuar mirë. Në relacionet dhe në raportet mbi realizimin e programit ekonomiko-financiar, nuk jepen shpjegime të sakta mbi arsyet dhe faktorët e realizimit ose mosrealizimit të treguesve të planifikuar.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë dhe Dega e Financës, për ngritjen e një grupi pune që të kryejë hartimin e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë afatmesëm dhe vjetor të mirëstudiuar mbi planifikimin e treguesve, i cili të bazohet në planin strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare,

projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Vazhdimisht

8. SHA UK Gjirokastrë nuk disponon certifikatë pronësie për asetet afatgjata të shoqërisë, për trojet dhe ndërtesën, në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.11.2004 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore*” i azhurnuar, me Pikën 5, të VKM nr. 660, datë 12.09.2007 “*Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore të kryejnë procedurat e regjistrimit të këtyre pronave, të miratuara me këtë vendim*”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë, Asambleja e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës për pajisjen me certifikatë pronësie për asetet afatgjata të shoqërisë, për trojet dhe ndërtesën në zbatim me VKM nr. 809, datë 26.11.2004, i azhurnuar.

Deri me 28.02.2015

9. Shoqëria për materialet që bëhen hyrje në magazinë nuk ka kartela përkatëse për çdo material, por ka vepruar sipas regjistrimit të magazinës. Kodifikimi i materialeve është bërë sipas çmimit të materialeve dhe jo sipas specifikimeve teknike, veprim ky në kundërshtim me pikën 83 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë dhe Dega e financës që në vazhdimësi për materialet që bëhen hyrje në magazine të regjistruhen në kartela dhe të bëhet kodifikimi i tyre, në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Deri me 31.01.2015

10. Në shoqërinë SHA UK Gjirokastrë konstatohet se në procedurën për nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve, anëtarët e komisionit të vlerësimit janë njëherësh edhe anëtarë të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit, veprim ky në kundërshtim me pikën nr. 97, të UMF nr. 30 ku citon “... në të gjitha rastet komisioni i vlerësimit të aktivave ka përbërje tjetër nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi në njësi të aktivave...” dhe ngarkon me përgjegjësi titullarin e shoqërisë dhe sektorin e financës.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e shoqërisë dhe Dega e financës që në vazhdimësi në zbatimin e procedurave për ngritjen e komisionit për nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve, anëtarët e komisionit të vlerësimit të mos jenë edhe anëtarë të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit.

Deri me 31.01.2015

11. Nga ana e shoqërisë nuk është ndërmarrë asnjë veprim për shkëputjen e lidhjeve të paligjshme ose dënimin e tyre si kundravajtje administrative, në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “*Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë*”, i ndryshuar, pika 5 dhe Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “*Për administrimin e ujit të pijshëm*”, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pika V, nënpika 6.

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e shoqërisë dhe nga Kryetari i degës teknike për shkëputjen e lidhjeve të paligjshme të konsumatorëve në sistemin e ujësjellësit sipas VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i ndryshuar, pika 5 dhe Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pika V, nënpika 6.

Vazhdimisht

12. Në shoqërinë UK Gjirokastër nuk është ngritur komisioni dhe nuk janë hartuar procesverbale, të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratave dhe kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia ...e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,.... Autoriteti kontraktor,...mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i shoqërisë të marrë masa, që në vazhdimësi të miratojë urdhërin për ngritjen e komisionit me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të plotësimit të dokumentacionit shoqëruar në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

Deri me 15.01.2015

13. Në të gjitha procedurat e prokurimit në SHA UK Gjirokastër, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit nuk është argumentuar llogaritja e fondit limit si dhe nuk është përcaktuar çmimi sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, pika 2, germa c dhe ç, “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen..... dhe, në çdo rast, i dokumenton ato”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e SHA UK Gjirokastër, për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga titullari.

Deri me 20.01.2015

14. Në Shoqërinë SHA Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër, nga stafi drejtues nuk ka njohje të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të ligjit të MFK dhe koncepteve të tij. Si rezultat i kësaj nuk është hartuar plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, nuk është përcaktuar një strategji, objektivat, si dhe nuk janë hartuar plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në zbatim të tij.

Për sa më sipër rekomandojmë:

a) Të merren masa nga Shoqëria UK Gjirokastrë, për përgatitjen si një proces gjithëpërfshirës nga niveli drejtues (Titullari) dhe stafi për të strukturuar mirë platformën e përshtatshme sipas ligjit të MFK, për hartimin e një plan-veprimi, ku të realizohen objektivat e shoqërisë me anë të:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe udhëzimet;*
- besueshmërisë dhe plotësisë së informacionit financiar dhe operacional;*
- efektivitetit dhe efencës së operacioneve;*
- ruajtjes së aseteve dhe informacionit*

b) Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Ngritja, menaxhimi dhe vlerësimi i sistemit të MFK të arrihet nëpërmjet:

- krijimit të një mjedisi kontrolli eficient dhe efektiv;*
- menaxhimit efektiv të riskut;*
- zbatimit të aktiviteteve të kontrollit;*
- menaxhimit të informacionit dhe komunikimit;*
- monitorimit të aktiviteteve të kontrollit në njësisë së krijuar.*

Brenda muajit Prill 2015

15. Në shoqërinë UK Gjirokastrë, për vitet 2012, 2013 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2014 konstatohet se:

- Mungon regjistri i parashikimit dhe i realizimit të dërguar në APP për prokurimet me vlerë të vogël në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime në kundërshtim me Pikën 3/b të Kreut I dhe Pikës 2/a Kreu i VI në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” Pika 1.4.

- Procedurat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla, paraqiten me parregullsi dhe mangësi në kundërshtim me Kreun e VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, të VKM nr. 47, datë 23.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 28, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5 e tij i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin e APP nr. 1 datë 28.02. 2014.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Të merren masa nga Shoqëria që deri më datë 31.01.2015 të hartohet regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe të paraqitet pranë Agjencisë së Prokurimit Publik në përputhje me formën dhe metodën që parashikohet në udhëzimin e APP nr. 28 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

Deri me 31.01.2015

16. Humbjet në rrjetin e ujës-jellësit Gjirokastër kanë ndodhur edhe nga mos lidhja e kontratave (mos faturimi), nga mungesa e të dhënave të sakta si rezultat i mosbashkëpunimit me institucionet e tjera për përcaktimin e numrit të familjeve dhe numrit të bizneseve, që nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë ujës-jellës kanalizime, gjë e cila nuk ka bërë të mundur gjykimin e drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarë apo biznese pa kontratë dhe ligjërimit të tyre në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i ndryshuar, Pika 1. Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa, nga Drejtoria e shoqërisë, për identifikimin e abonentëve familjarë, subjekteve privatë dhe institucione, duke përcaktuar zonën sipas vendndodhjes së tyre dhe të ndiqen hapat ligjore për të lidhur kontratat e furnizimit me ujë. Të ngrihet grup pune i përbashkët me Bashkinë Gjirokastër për azhurnimin e të dhënave për numrin e familjeve dhe bizneseve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, me numrin e familjeve në Zyrat e Gjendjes Civile të këtyre njësive vendore, numrin e familjeve që kanë lidhur kontratë me CEZ Shpërndarje në Gjirokastër, si dhe numrin e subjekteve private në Drejtorinë e Tatim Taksave Gjirokastër.

Brenda muajit Mars 2015

17. Në blerjet e kryera me bankë dhe me arkë, në të gjitha rastet nuk ka kërkesë të argumentuar në mënyrë të saktë për përcaktimin e nevojave mbi bazën të cilëve del urdhëri i prokurimit, veprim ky në kundërshtim me UMF nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3 dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga shoqëria që nga përgjegjësit e sektorëve të shoqërisë të paraqesin kërkesat të argumentuara për mallra dhe shërbime dhe mbi bazën e tyre të kryhet llogaritja e fonditlimit si dhe të hartohen urdhrat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla.

Vazhdimisht

18. Në katër investime me karakter emergjent në vlerën 1,617,734 lekë, realizimi i punimeve nuk është shoqëruar me dokumentacion justifikues, nuk është hartuar projekt zbatimi, preventivat nuk janë miratuar nga Drejtori, nuk është mbajtur ditar dhe librezë masash, nuk është caktuar mbikëqyrës punimesh, nuk janë mbajtur procesverbale për punime të maskuara, mungon dokumentacioni fotografik, nuk ka certificate cilësie për materialet e përdorura në zbatim, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001, të ndryshuar “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, KTP dhe KTZ.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria që në zbatimin e punimeve pavarësisht nga natyra dhe emergjenca e tyre, të ngarkohet mbikëqyrësi i punimeve dhe dokumentacioni justifikues të plotësohet sipas akteve ligjore dhe konkretisht sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për

menaxhimin dhe kontrollin financiar”, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3, datë 15.02.2001, të ndyshuar “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, KT te projektimit dhe KT të zbatimit.

Vazhdimisht

19. SHA UK Gjirokastrë rezulton se nuk ka njohuri mbi funksionimin e auditimit të brendshëm sipas Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe nuk ka një strukturë që të funksionojë si njësi e audit të brendshëm.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga shoqëria për të ngritur njësinë e auditit të brendshëm në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007.

Brenda muajit Mars 2015

20. Nga Asamblea e aksionerëve dhe nga Këshilli Mbikëqyrës të SHA Ujësjeles Kanalizime Gjirokastrë të bëhet shqyrtimi i Raportit Përfundimtar për nxjerrjen e përgjigjesive sipas rekomandimeve të lëna nga grupi i auditivit të KLSH për çdo person të atakuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Kryetari i Asamblesë së Aksionerëve dhe Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të marrin në analizë rekomandimet e lëna nga KLSH dhe të nxjerrin përgjigjësitë individuale për person të atakuar në Raportin Përfundimtar.

Deri më 31.01.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga Administratori i Shoqërisë “UK Gjirokastrë” sh.a (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim evidentimin dhe njohjen e shpërblim dëmit në vlerën **3,479,151** lekë.

1. Drejtori i shoqërisë SHA UK Gjirokastrë ka paguar një punonjës më tepër se struktura organizative e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, në kundërshtim me vendimin nr. 12, datë 02.02.2012 të Këshillit Mbikëqyrës duke shkaktuar **një dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 34,099 lekë** dhe ngarkon me përgjigjësi drejtorin e shoqërisë z. [REDAKTUAR]

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë dhe sektori i financës që të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 34,099 lekë, të përfutur padrejtësisht nga punonjësi i shoqërisë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë

2. Drejtori i shoqërisë SHA UK Gjirokastrë, për vitin 2012 ka paguar punonjësit e shoqërisë me gjysmë page shpërblim bashkë me shpërblimin për lejen e zakonshme, në kundërshtim me nenin 6, pika 1, shkronja (b) të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" ku citon "...Për masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës..." duke shkaktuar **një dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 1,366,170 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e shoqërisë z. [REDAKTUAR] dhe Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës z. [REDAKTUAR]

-Për vitin 2013 nga Drejtori i shoqërisë SHA UK Gjirokastrë janë paguar punonjësit e shoqërisë me gjysmë page shpërblim bashkë me shpërblimin për lejen e zakonshme, në kundërshtim me nenin 6, pika 1, shkronja (b) të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" ku citon "...Për masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës..." duke shkaktuar **një dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 1,286,500 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e shoqërisë z. [REDAKTUAR] dhe Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës z. [REDAKTUAR]

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë dhe sektori i financës që të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 1,366,170 lekë të përfutur padrejtësisht nga punonjësit shoqërisë për gjysmë page shpërblim, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit".

-Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë që të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 1,286,500 lekë të përfutur padrejtësisht nga punonjësit për gjysmë page shpërblim bashkë me shpërblimin për lejen e zakonshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit".

Menjëherë

3. Për vitin 2012 Drejtori i shoqërisë SHA UK Gjirokastrë për 14 punonjës ka paguar për shpërblimin e fundvitit me një pagë e gjysëm, në kundërshtim me nenin 6, pika 1, shkronja (b) të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" ku citon "...Për masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës..." duke shkaktuar **një dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 306,160 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e shoqërisë z. [REDAKTUAR] dhe Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës z. [REDAKTUAR]

-Për vitin 2013 nga Drejtori i shoqërisë SHA UK Gjirokastrë janë paguar 18 punonjës për shpërblimin e fundvitit me një pagë e gjysëm, në kundërshtim me nenin 6, pika 1, shkronja (b) të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" ku citon "...Për masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës..." duke shkaktuar **një dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në vlerën 365,000 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin e shoqërisë z. [REDAKTUAR] dhe kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës z. [REDAKTUAR]

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Drejtori i shoqërisë që të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 306,160 lekë të përfituar padrejtësisht nga punonjësit e shoqërisë për shpërblimin e fundvitit me një pagë e gjysmë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

-Të merren masa nga Drejtori i shoqërisë që të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 365,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga punonjësit e shoqërisë për shpërblimin e fundvitit me një pagë e gjysmë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë

4. Në tenderin me objekt “Blerje karburant 2012” nga llogaritja e gabuar e fondit limit është shkaktuar **një dëm ekonomik buxhetit të shoqërisë në vlerën 23,599 lekë**, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” i ndryshuar, Kreu II, Pika 1, geramat (c) dhe (ç) dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e shoqërisë dhe anëtarët e KVO, znj. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR]

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtori i shoqërisë që, për anëtarët e KVO të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 23,599 lekë të përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik për rritje fiktive të fondit limit, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë

5. Në tenderin me objekt “Blerje Automjet Fuoristradë” nga llogaritja e gabuar e fondit limit është shkaktuar **një dëm ekonomik në vlerën 11,000 lekë**, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” i ndryshuar, Kreu II, Pika 1, geramat (c) dhe (ç) dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e shoqërisë z. Dashmir Qeli dhe anëtarët e KVO, znj. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR]

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtori i shoqërisë që, për anëtarët e KVO të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 11,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik për rritje fiktive të fondit limit, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë

6. Në tenderin me objekt “Blerje karburant 2013” nga operatori ekonomik fitues për likuidimin e sasisë 11.400 litra naftë ka një rritje të çmimit referuar çmimeve të bursës REUTERS për “gazoil (10 ppm ULSD)” duke i shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të SHA UK Gjirokastër **në vlerë 31,673 lekë**, në kundërshtim me zbatimin e kontratës neni 5 “Çmimi i kontratës” ku citon “... Çmimi që i paguhet Kontraktuesit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të kontratës është për Gazoil D-1...” në këto rrethana rezulton se nuk është zbatuar kontrata plotësisht dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërinë “Flladi Petroleum” sh.p.k me administrator [REDAKTUAR]

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtori i shoqërisë që, për z. [] të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 31,673 lekë të përfituar padrejtësisht për rritje të cmimit, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë

7. Në zbatimin e punimeve me objekt “ Ndërtimi i linjës së ujësjellësit në SMT ” Gjirokastrë, i trajtuar si investim rezulton se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, nuk është i plotë dhe i saktë, si dhe ka krijuar efekte financiare në dëm të buxhetit të shoqërisë ***në vlerën 4,950 lekë.***

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtori i shoqërisë që, për kryetarin e degës teknike z. [] përgjegjës in e sektorit hidraulik dhe përgjegjës in e punimeve të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 4,950 lekë.

Menjëherë

8. Në shoqërinë SHA UK Gjirokastrë për periudhën objekt auditimi, janë paguar shpenzime për udhëtime e dieta për punonjësit jashtë qendrës së punës brenda vendit, të pa shoqëruar me dokumentacionin justifikues, si urdhër shërbimi, pa nënshkruar nga titullari ku të përcaktohen qëllimi i shërbimit, afati i kryerjes së tij, punonjësit të cilët shkojnë me shërbim, etj.

Nga auditimi i dokumentacionit për këto shpenzime, u konstatuar 5 raste ku dokumentacioni justifikues nuk është i plotë, ku praktika e shërbimit nuk ka faturën tatimore si dhe ka pasaktësi në plotësimin e urdhërave të shërbimit, veprim ky në ***në kundërshtim me VKM nr. 997, duke shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të shoqërisë në vlerën 50,000 lekë.***

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë që, për z. [] z. [] dhe znj. [] të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 50,000 lekë të përfituar në mënyrë të padrejtë duke i shkaktuar dëm buxhetit të shoqërisë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin nr. 37, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe kontratës individuale neni 9, kërkojmë nga Drejtori i SHA Ujësjellës Kanalizime, Gjirokastrë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Vërejtje”, për:

1. [] me detyrë përgjegjëse e financës, në cilësinë e kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 139, datë 14.11.2014, me nr. 2, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 140, datë 14.11.2014; me nr.4, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 142, datë 14.11.2014; nr. 5, datë 14.11.2014, të protokolluar me nr. 143, datë 14.11.2014; nr. 6, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr 144, datë 14.11.2014)

2 [] me detyrë specialist, në cilësinë anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të komisionit të blerjeve me blera të bogla dhe të mëdha. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1,

datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 139, datë 14.11.2014; nr. 2, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 140, datë 14.11.2014; me nr.4, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 142, datë 14.11.2014; nr. 5, datë 14.11.2014, të protokolluar me nr. 143, datë 14.11.2014; nr. 6, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr 144, datë 14.11.2014)

3. ■■■■■ me detyrë specialist, në cilësinë anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të komisionit të blerjeve me blera të bogla dhe të mëdha. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 1, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 139, datë 14.11.2014; nr. 5, datë 14.11.2014, të protokolluar me nr. 143, datë 14.11.2014)

4 ■■■■■ me detyrë ing. Mekanik (specialist i jashtëm), në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 2, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 140, datë 14.11.2014)

5. ■■■■■ me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 4, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 142, datë 14.11.2014; nr. 5, datë 14.11.2014, të protokolluar me nr. 143, datë 14.11.2014; nr. 6, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr 144, datë 14.11.2014)

6. ■■■■■ me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimeve në blerjet e vogla. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 7, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 145, datë 14.11.2014)

7 ■■■■■ me detyrë financiere, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimeve në blerjet e vogla, si dhe anëtare e KVO. (Trajtuar në proces verbalin , me nr. 7, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 145, datë 14.11.2014)

8. ■■■■■ me detyrë inxhinier Hidro, në cilësinë e Drejtorit të degës teknike.

-për mos mbajtje dekomentacioni në zbatimin e punimeve , mos hartimin e projekt zbatimit, për mos zbatim të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit, veprime këto në kundërshtim ligjin nr. 10296, datë 08.07.201 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin dhe kontrollin financiar, me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 të ndryshuar “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

(Trajtuar në proces verbalin , me nr. 8, datë 14.11.2014 të protokolluar me nr. 146, datë 14.11.2014)

Punonjësit e lartpërmendur (nga nr.1 në nr. 7) në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla dhe të mëdha kanë vepruar në kundërshtim me Kreun e VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar VKM nr. 47 datë 23.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45 datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe Udhëzimi i APP nr. 28 datë 18.02.2008 “ Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5 e tij i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin e APP nr. 1, datë 28.02. 2014, me UMF nr. 92, datë 29.12.2011 “ Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë ” tabela 1/3 dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “ Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 10 dhe Kapitulli “Dokumentimi lëvizjes së aktiveve”pika 35/b dhe 36.

(Trajtuar në proces verbalet e sipërpërmendur , faqet 40-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Skender Muça, Blerin Shkurti, Orges Levani, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT